Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-64
Datë: 13.02.2025

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016 Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 23.01.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN (përmirësim) e vendimit me Nr. 01/440, datës 21.07.2023 të mbledhjes se IV e mbajtur me date 19.07.2023 për KEK MED.

Korrigjohet (ndryshohet) vendimi i KD së AKK Nr.01/440, datës 21.07.2023 te mbledhjes se IV e mbajtur me date 19.07.2023 të Institucionit KEKA MED në pikat: 1.1, 1.2 dhe 1.3 të vendimit.

1. Korrigjohen (ndryshohen) pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 e vendimit të KD së AKK-së Nr. 01/440, datë 21.07.2023, në të cilën përmirësohen: ne piken 1.1 fjala procesin e trajnimit të zëvendësohet me procesin e mësimit, fjala kandidat te zëvendësohet ne fjalën nxënës per një klase/grup, ndërsa ne piken 1.2 te lloji i Kualifikimit Kombëtar i Kombinuar (D) te jete Kualifikim i Kombinuar (C), fjala procesin e trajnimit të zëvendësohet me procesin e mësimit, po ashtu fjala kandidat ne një klase/grup te zëvendësohet ne fjalën nxënës per një klase/grup, ndërsa ne piken 1.3 te lloji i Kualifikimit Kombëtar i Kombinuar (D) te jete Kualifikim i Kombinuar (C), fjala procesin e trajnimit të zëvendësohet me procesin e mësimit, po ashtu fjala kandidat ne një klase/grup te zëvendësohet ne fjalën nxënës per një klase/grup.

   1.1. **ASISTENT DENTAR**, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e mësimit me njëzetepesë-deri tridhjete (25-30) nxënës me një klase/grup, 1 klase brenda vitit

   1.2. **TEKNIK I FARMACISË,** Niveli III dhe IV i KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizoj procesin mësimore

deri me njëzetetetë (28) nxënës në një grup, duke lejuar një numër maksimal prej 28 nxënësve në klasë për një vit shkollor.

1.3. **BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL I INFERMIERISË**, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C), me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor me Dy (2) klasa/grupe me nga njëzetetetë (28) nxënës për një klase/grup, brenda vitit shkollor.

2. Pjesa tjetër e vendimit të KD së AKK 01/440 të datës 21.07.2023, mbetet e pa ndryshuar.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit KEKA MED për plotësim ndryshim të këtij vendimi KD i AKK-së ne mbledhjen e pare të datës 23.01.2025 përmes dëshmive të ofruara për gabimin teknik administrativ dhe mbi bazën e dëshmive të ofruara dhe administrimin e provave, KD AKK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD së AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- IAAP KEK MED;
- Arkivit të AKK.

Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK